

# DITARI MUJOR

QERSHOR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

## BP, BASHKË KUNDËR KORRUPSIONIT NË KONFERENCËN E UNODC

U zhvillua në Tiranë Konferenca e Dytë Rajonale e UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin) për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, duke e shndërruar Tiranën kryqëndrën rajonale me prezencën e pjesëmarrësve të nivelit të lartë nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Ministri e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, tha në fjalën e saj se reforma në drejtësi po rishkruan faqen e re të Shqipërisë evropiane duke u shndërruar në "kalin e betejës" për avancimin e procesit të aderimit në BE. Në fund të punimeve tre ditore të konferencës u hartua Udhërrëfyesi i ri Tirana 2024, i cili do të konsolidojë më tej bashkëpunimin midis strukturave përgjegjëse në gjashtë vendet e BP duke sjellë ekspertizën më të mirë në funksion të ngritjes së mekanizmave për të luftuar korrupsionin.



## KONFERENCA E VI KOMBËTARE MBI TË DREJTËN PËR INFORMIM, PIRDENI: TRANSPARENCA MBI PUNËN E ADMINISTRATËS, USHQYES I PAZËVENDËSUESHËM I BESIMIT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë bashkë-organizuar Konferencën e VI Kombëtare "E Drejta për Informim - Ndërtimi i besimit - Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit". Në fjalën e saj, Ministri e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, tha se në vitin 2023 u mundësua përshtatja e kuadrit ligjor sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe se u miratua ligji për të dhënat e hapura dhe për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik. Ndërkaq, Ministria Pirdeni thaksoi separaqitet si nevojë absolute reduktimi i problematikave krejtësisht të shmangshme në transparencën e informacionit për publikun, të cilat dëmtojnë në mënyrë të panevojshme imazhin dhe punën e zyrtarëve publikë. eksperte, përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët me tone kritike referuan mbi rolin e aksesit në informacion sipas parimeve të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies.



## ZHVILLOHET TAKIMI I 12-TË I GRUPIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE BE - SHQIPËRI

U zhvillua Takimi i 12-të i Grupit të Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE-Shqipëri, që është dhe platforma kryesore Shqipëri-BE për të çuar përpara Reformën e Administratës Publike. Në këtë takim, Ministria Pirdeni u ndal tek të gjitha hapat konkrete të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në drejtim të mirëqeverisjes.



Ministër i Shtetit për Administratën  
Publike dhe Antikorrupsionin  
Adea Pirdeni



mapa.gov.al  
adeapirdeni



APirdeni

# DITARI MUJOR

QERSHOR 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

## KKIE, MINISTRJA PIRDENI SHPALOS DETAJE NGA KUADRI I RI STRATEGJIK ANTIKORRUPSION

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, raportoi në Këshillin Kombëtar të Integritimit Evropian. Ministrja Pirdeni bëri me dije zotimet e ndërmarra deri në vitin 2030 përmes dy dokumenteve kyçe siç janë Udhërrëfyese për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyese për Reformën në Administratën Publike, të cilat janë dokumente të dakordësuara me të gjitha institucionet përkatëse të linjës, ku përfshihen këtu edhe shumë institucione të pavaruara. Më tej Ministrja Pirdeni u shpreh gjatë fjalës së saj se po rishikohet kuadri strategjik antikorrupsion, me synim të qartë targetimin përmes masave specifike të sektorëve më të ndjeshëm ndaj korrupsionit.



## PËRMBYLLET PROJEKTI PILOT "OBJEKTIVAT KASKADË DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS"



Është përmbyllur trajnimi i stafëve drejtuese në kuadër të Projektit Pilot "Objektivat Kaskadë dhe Vlerësimi i Performancës". Ky projekt synon të rrisë objektivitetin e vlerësimit në punë të çdo punonjësi dhe linjëzimin e performancës individuale me objektivat e çdo ministrie në administratën publike. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, ishte e pranishme në takimin përmbyllës të trajnimit të stafëve drejtuese ku u diskutua mbi rëndësinë e rienergjitimit të administratës, fuqizimin e burimeve njerëzore ekzistuese, si dhe mbi domosdoshmërinë e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës së punonjësve, me kryefjalë meritokracinë.

## MINISTRJA PIRDENI NË TAKIMIN E RESPA-S: FORCOJME KAPACITETET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, mori pjesë në takimin e organizuar nga ReSPA (Shkolla Rajonale e Administratës Publike) dhe Ministria për Transformimin e Shërbimit Publik e Republikës së Francës. ReSPA, si aktor i rëndësishëm në rajon ka në fokus të punës modernizimin e shërbimit publik dhe shkëmbimin e përvojave për transformimin e administratës, me qëllim përballimin e sfidave të procesit të anëtarësimit në BE. Ministrja Pirdeni tha në fjalën e saj se objektivi kryesor i strategjisë së Shqipërisë është anëtarësimi në BE, teksa shtoi se jemi të vetëdijshëm për nevojën për të forcuar kapacitetet e administratës publike si një domosdoshmëri për mirëqeverisjen dhe përmirësimin e standardeve në shërbimet publike.

